

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata vlerëson të paligjshme arrestimet e 12 protestuesve të hënën
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/17/gjykata-vlereson-te-paligjshme-arrestimet-e-12-protes
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:43:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 13:28:46 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	93e0bc05e3171b5f4879817ffc00e8dc71184c0ed26106534fe9220992bb6db
TEKSTI	b99db0d17c1317dbdc510f00857bc04768643d13b2d73a83ed13d19b461ce6ba
PAMJA	68a1b44511e8ab73b92800fcc2d3721993cd2726db309ce0bc865701ff5c5e5d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	87c6298d5110f0d4b278601313bdf3273fccb8cd85dfcf415376b5438cdebe
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/87c6298d5110f0d4b278601313bdf3273fccb8cd85dfcf415376b5438cdebe>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Lajme

Gjykata vlerëson të paligjshme arrestimet e 12 protestuesve të hënën

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë i vlefhtësoi të paligjshme ndalimet nga policia të 12 protestuesve mëngjesin e të hënës dhe vendosi të mos caktojë asnjë lloj mase sigurimi personal ndaj tyre.



nga Edmond Hoxhaj — 13 seconds më parë

në Artikull kryesor, Lajme, Revolucion i Flamingove Koha e leximit: 2 min lexim

AA 0



Protesta e Flamingove, të hënën, më 14 shtator 2026, Foto LSA

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë i vlerësoi të paligjshme gjithë ndalimet e protestuesve të kryera të hënën gjatë zhvillimit të tubimit në vendin e quajtur Zogu i Zi. Vendimi u mor të enjten më 17 shtator. Përmes një njoftimi të shpërndarë për mediat, gjykata bëri me dije se, pasi u njohën me argumentimin e bërë nga organi i akuzës, si dhe me qëndrimet e kërkesat e 12 të arrestuarve, vendosi të vlefhtësojë të paligjshëm arrestimet të flagrancë dhe mos caktimin e asnjë mase sigurie ndaj tyre.

Policia njoftoi se mëngjesin e 14 shtatorit, një grup personash u grumbulluan në sheshin "Skënderbej", për tubim, pa marrë leje dhe vijuan marshimin drejt Rrugës së Durrësit, ku ndaluan pranë një gjimnazi duke u bërë thirrje nxënësve për bojkotimin e procesit mësimor dhe pjesëmarrje në tubimin. Policia pretendoi se ishte cënuar perimetri i sigurisë në shkollë dhe ishte bllokuar trotuari dhe shoqëruan dhjetëra protestues, 12 prej të cilëve i arrestuan. Po ashtu, policia referoi materialet në prokurori edhe për 15 protestues të tjerë, të ndjekur në gjendje të lirë.

Pretendimet e policisë se protestuesit e ndaluar kishin organizuar grumbullime të paligjshme, se kishin kundërshtuar punonjësit e policisë dhe nuk i'u ishin bindur urdhërave të tyre, se kishin prishur qetësinë publike dhe kishte shtyrë të miturit në krim, u gjetën të pabazuara nga gjykata, që i vlerësoi arrestimet të paligjshme.

Dy javë më parë, Gjykata e Tiranës e rrëzoi një kërkesë tjetër të prokurorisë, duke i vlerësuar të paligjshme arrestimet e 14 protestuesve nga policia mbrëmjen e 1 shtatorit para godinës së Këshillit të Ministrave.

Prej afro katër muajve, mijëra qytetarë protestojnë çdo natë në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhe kërkojnë dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama, të cilin e akuzojnë për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar. Lëvizja është pagëzuar nga media ndërkombëtare si "Revolucioni i Flamingove".

Gjykata vlerëson të paligjshme arrestimet e 12 protestuesve të hënën

15:28 | 17/09/2026

Dy ish-drejtorë të ASHK-së Fier nën akuzë për tjetërsim të 1143 ha toke në Seman

12:13 | 17/09/2026

PS refuzon hetimin parlamentar për kontratat e shoqërisë "KAYO"

12:03 | 17/09/2026

Censurë, IA dhe deepfake: Lufta online rreth 'Revolucionit të Flamingove'

07:45 | 17/09/2026

Institucionet e drejtësisë kundërshtojnë projektligjin për pagat e magjistratëve

17:51 | 16/09/2026

Ish-presidenti Hashim Thaçi dhe liderët e UÇK-së dënohen për krime lufte

13:07 | 16/09/2026

Reporter.al

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni

Rreth nesh
Stafi
Kontakttoni
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatësisë dhe
rregulla të tjera
Letra për redaktorin

Follow Us



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by Slida.PRO

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.